

## KONTRATË DHURIMI

Sot, më datë 24 maj 2021 lidhet kjo Kontratë Dhurimi ndërmjet:

**Bardhul Brovina**, shtetas shqiptar, lindur më 04.06.1950, në Tiranë me letërnjoftim me nr. 024484612 dhe nr. personal F00604059M, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e "**Dhuruesit**";

**Diana Brovina**, shtetase shqiptare, lindur më 15.03.1959 në Tiranë, më letërnjoftim më nr. 033877676 dhe nr. personal F95315232T, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e "**Dhënëses së Pëlqimit**"; dhe

**Kujtim Brovina**, shtetas shqiptar, lindur më 25.05.1946, në Tiranë me letërnjoftim me nr. 024749105 dhe nr. identifikimi personal E60525018O, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar "**Pranuesi i Dhurimit**"

Hyrje:

Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Dhurimi Dhuruesi zotëron 100% të pjesëve të kapitalit në shoqërinë AGIMI B SHPK shoqëri e të drejtës shqiptare, e regjistruar me NIPT K41531005T ("**Shoqëria**"), ka vendosur t'i dhurojë *Pranuesit të Dhurimit* 50 përqind të pjesëve të tij në kapitalin e shoqërisë; *Pranuesi i Dhurimit* e pranon dhurimin.


Për sa më sipër palët lidhin këtë Kontratë Dhurimi me kushtet e mëposhtme:

### Neni 1 - Objekti

- 1.1 Me anë të kësaj Kontrate Dhurimi, *Dhuruesi* i transferon me dhurim pjesën e kuotës(ave) që përfaqëson 50 (pesëdhjetë) përqind të kapitalit *Pranuesit të Dhurimit* që e pranon dhurimin.
- 1.2 Pas transferimit, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:
  - Bardhul Brovina, 50% të kuotave që përfaqëson 725,000 lekë në kapitalin e Shoqërisë;
  - Kujtim Brovina, 50% të kuotave që përfaqëson 725,000 lekë në kapitalin e Shoqërisë.

### Neni 2 - Efektet e transferimit

- 2.1 Transferimi i pjesëve të kapitalit bëhet pa kundërshtëpërblim.
- 2.2 Kalimi i pronësisë mbi 50% të kuotave në kapitalin e Shoqërisë dhe fitimi i cilësisë së ortakut kryhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.



### **Neni 3 - Deklarime dhe Garanci**

- 3.1 *Dhuruesi* garanton *Pranuesin e Dhurimit* se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.2 Dhënësi i Pëlqimit jep pëlqimin e tij të plotë dhe përfundimtar në lidhje me dhurimin dhe pranon të gjitha kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.
- 3.3 *Pranuesi i Dhurimit* është mbajtës i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve përkatëse pas transferimit të pjesëve të kapitalit sipas kësaj Kontratë Dhurimi duke përfshirë marrjen pjesë në fitimet e Shoqërisë.
- 3.4 *Pranuesi i Dhurimit* deklaron se kupton që pjesët e kapitalit janë të lidhura me qenien si ortak në Shoqëri dhe transferimi i tyre tek të tretët i nënshtrohet përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

### **Neni 4 - Interpretimi i Kontratës**

Kjo Kontratë Dhurimi do të interpretohet duke analizuar përmbajtjen e saj në tërësi. Në çdo rast, nëse ndonjë nen ose fjalë është e paqartë, ajo duhet të shikohet në tërësinë e kësaj kontrate dhe në kuadrin e qëllimeve të të dyja palëve për të lidhur këtë Kontratë Dhurimi.

### **Neni 5 - Informacioni dhe Dokumentet**

Informacioni dhe dokumentet në këtë Kontratë Dhurimi janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota, deri në këtë datë.



### **Neni 6 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo Kontratë Dhurimi do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët, në rast të kundërt palët do t'i drejtohen Gjykatës kompetente shqiptare.

### **Neni 7 - Të ndryshme**

- 7.1 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 7.2 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën Shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore.

[FAQJA E NËNSHKRIMEVE VIJON]



**DHURUESI**

**Bardhul Brovina**

BARDHUL BROVINA

*Bardhul Brovina*

---

**DHËNËSI I PËLQIMIT**

**Diana Brovina**

*Diana Brovina*

---

**PRANUESI I DHURIMIT**

*Kujtim Brovina*

Kujtim Brovina

*Kujtim Brovina*

---